



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUESE**

“Pergjegjes i Sektori i investimeve dhe mirembajtje rruge”

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**Pergjegjes i Sektori i investimeve dhe mirembajtje rruge”, Klasifikuar -
Kategoria:III-a**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

11 DHJETOR

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:
LËVIZJE PARALELE**

11 DHJETOR

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:
NGRITJE NË DETYRË**

- siguron dhe mban përgjegjësi që menaxhimi i kontratave për përgatitjen e projekteve dhe zbatimin e investimeve për ndërtesat urbane të realizohen në kohë, brenda buxhetit të miratuar dhe me cilësinë e parashikuar në kushtet e kontratës;
- përgatit dosjen me dokumentacionin përkatës për ndërtesën urbane dhe e dorëzon atë zyrtarisht tek mbikqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve, si dhe i pajis këta të fundit me çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm

- ndjek dhe koordinon procedurën për lirim të shesheve të ndërtimit dhe azhurnimet e ndryshme të dosjeve të objekteve duke bërë të mundur realizimin e kontratave të shërbimit të ndërtesave në afat, në bashkëpunim me Inspektorin e Mbrojtjes së Territorit, Policinë Bashkiake dhe Sektorin e shërbimeve Sociale etj;
- vlerëson, propozon dhe mban përgjegjësi në lidhje me ndryshimet që kërkohen gjatë zbatimit të projekteve, e në rast konstatimi të ndryshimeve thelbësore dhe teknike të projekteve ndërtesave urbane që ndodhin gjatë zbatimit, përgatit dosjen përkatëse dhe e depoziton në Sekretarinë Teknike për t'u diskutuar dhe miratuar në Këshillin Teknik;
- përmbush detyrat që lidhen me menaxhimin dhe financimin e të gjitha kontratave të shërbimit të ndërtesave, përfshirë raportimin periodik, teknik dhe financiar mbi ecurinë e zbatimit dhe realizimit të tyre;
- mban përgjegjësi për kontrollin e situacioneve dhe dokumentacionit përkatës për çdo pagesë, për punimet që prekin fondin rezervë si dhe për punimet që ndryshojnë nga preventivi i kontratës;
- verifikon e kontrollon punën e kontraktorëve (sipërmarrës, mbikqyrës, kolaudator), bashkëpunon me ta si dhe propozon masa konform ligjit dhe kontratës në rastet kur vëren shkelje të kontratës dhe kushteve të saj;
- mbikqyr dhe kryen kontrole individualisht apo në grup mbi veprimtarinë e subjekteve kontraktore sipërmarrëse apo të shërbimeve për të siguruar respektimin e detyrimeve kontraktuale e ligjore, efektivitetin dhe cilësinë e punimeve;
- përgatit dokumentacionin dhe procedurat për emërimin e kolaudatorëve të objekteve, kontrollon afatet e përfundimit të punimeve (duke informuar një muaj përpara përfundimit të punimeve të parashikuar në kontratë) dhe kërkon e siguron dorëzimin në afat të dosjes së mbikqyrësit të punimeve në përfundim të punimeve të objektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- realizon kontrollin e gjendjes së punimeve në objektet që janë në periudhën e garancisë nëpërmjet kontrolleve periodike të planifikuara, harton relacionet përkatëse për difektet e konstatuara e propozon afatin e kryerjes së riparimeve të nevojshme, si dhe mban përgjegjësi për sigurimin e zgjidhjes së problemeve të evidentuara sipas kushteve të kontratës;
- ndjek procedurën për plotësimin e dokumentacionit të dosjes së objekteve, arkivimin e tyre pas përfundimit të periudhës së garancisë dhe i paraqet drejtorive përkatëse kërkesat për kalimin e objekteve në fondet themelore të ndërmarrjeve përkatëse;
- përgatit dhe mban përgjegjësi për vlerësimet/referencat e ndryshme për punimet që kanë kryer kompanitë projektuese, ndërtuese dhe mbikqyrësit e punimeve;
- të sigurojnë mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e hapësirave publike, me shpenzimet e veta, përfshirë në pronë private, pa cenuar të drejtën e pronarëve për zhvillimin e tyre deri në momentin e kryerjes së zhvillimit;
- të garantojë që parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Bashkisë, plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara;
- të sigurohet që punimet e ndërtimit, janë projektuar dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit,

kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre;

- *të kryejë punimet e ndërtimit në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse;*
- *të sigurojë që të kryhet oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve;*
- *të vendosë për çdo projekt ndërtimi në Bashki mbikëqyrësin e punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga Bashkia, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë;*
- *të kryejë zbatimin e punimeve të ndërtimit vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Gjithashtu, struktura përgjegjëse e bashkisë duhet të garantohet që zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe realizon punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.*
- *Në çdo rast, zbatuesi i punimeve duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane;*
- *të garantohet që të gjitha punimet e ndërtimit t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik; kolaudimi i objektit duhet të kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.*
- *Në çdo rast, struktura përgjegjëse e Bashkisë duhet të kontrollojë që materialet e ndërtimit të importit duhet të jenë të shoqëruara me certifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Europian. Në rastet kur këto materiale janë prodhuar në vend, duhet të pajisen me certifikatë cilësie nga laboratorët e akredituar nga Drejtoria e Standardeve dhe e Cilësisë.*

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, Hidrologjisë, Inxhinierisë së Mjedisit, Inxhinierisë Elektrike

b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në administratën shtetërore vendore.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: **11.12.2017**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.12.2017** Bashkia Roskovec do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Kandidatet të cilët rezultojnë të pakualifikuar brenda 3 (tre) diteve nga shpallja e listës paraprake të verifikimit të kandidateve, në datën 15.12.2017 kanë të drejtë të përqasur ankesat e tyre në njësine e menaxhimit të burimeve njerezore. Brenda 3 (tre) diteve pune nga data e paraqitjes së ankesës me datë 18.12.2017 njësia e menaxhimit të burimeve njerezore u kthen përgjigje kandidateve të pakualifikuar.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”.
- Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- Ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës se Shqiperise”;
- Ligjin Nr.107/2014 te miratuar me date 31.07.2014 “Per planifikimin e territorit” i ndryshuar
- Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pikë, **i ndare ne:**

- 10 pike per jeteshkrimin,
- 10 pike per eksperiencen,
- 5 pike per trajnimet ,
- 10 pike per trajnimet lidhur me fushen perkatese
- 5 pike per vlesimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikeve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2 NGRITJA NE DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-a, IV-b;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në fushën e Inxhinierisë së Ndertimit, Hidrologjisë, Inxhinierisë së Mjedisit, Inxhinierisë Elektrike
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në administratën shtetërore vendore;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore brenda datës: **11/12/2017**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18/12/2017**, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve

që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Brenda 5 diteve kalendarike nga data e e shpalljes se listes kandidatet e pakualifikuar kane te drejte te paraqesin ankese prene Njesisë se menaxhimit te burimeve njerezore deri me date 26.12.2017. Ankuesi merr pergjigje brenda dates 05.01.2018.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim me date 09.01.2018 në lidhje me:

- *Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore”.*
- *Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.*
- *Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.*
- *Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”*
- *Ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i proçedurave administrative të Republikës se Shqiperise”;*
- *Ligjin Nr.107/2014 te miratuar me date 31.07.2014 “Per planifikimin e territorit” i ndryshuar*
- *Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”*

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 70 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 15 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Komisioni i Ngritjes ne detyre brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më date **10.01.2018**

I ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, brenda dates 11.01.2018 shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik te Bashkise Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : *evisa.mustafaj@yahoo.com*

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC